

**VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 1 Mars 2002, unë Anila Capo, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Alban Caushi në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqërisë “Partneri Shqiptar në Mikrokredi” SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqëria “Partneri Shqiptar në Mikrokredi” SH.A. është person juridik i së drejtës shqiptare dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 25341, datë 2 mars 2001, me aksioner të vetëm shoqërinë “Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe)” shoqëri e krijuar në bazë të ligjit anglez të shoqërive të vitit 1985 me numër 3516266, me seli në adresën Rruga “Gjin Bue Shpata”, Nr. 7/1, Tiranë.

Më datë 20 dhjetor 2001 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerit të Vetëm të shoqërisë “Partneri Shqiptar në Mikrokredi” SHA, e cila ka marrë vendim: 1) për shitjen e 19.944 aksioneve nga totali prej 24.187 aksione, shoqërisë Opportunity Transformation Investments. Këto aksione janë shlyer nga shoqëria Opportunity Transformation Investments plotësisht kundrejt shumës 199.446.516 Lekë (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë lekë); 2) pranimin si aksioner, shoqërinë e shtetit Illinois Opportunity Transformation Investments e themeluar më 19 qershor 2000.

Më datë 4 dhjetor 2001 është zhvilluar mbledhja e Bordit të Drejtorëve të shoqërisë Opportunity Transformation Investments, e cila ka marrë vendim për blerjen e 19.944 aksioneve që i korrespondojnë vlerës në Lekë 199.446.516 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë lekë); si dhe për emërimin e Z. Kenneth Vender Weele në të veprojë në emër të Opportunity Transformation Investments për marrjen e vendimeve me rëndësi në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Më datë 20 dhjetor 2001 është lidhur dhe kontrata për shit-blerjen e aksioneve midis shoqërive Opportunity Transformation Investments dhe “Partneri Shqiptar ne Mikrokredi” SHA.

**PËR KËTO ARSYE:**

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”,

**VENDOSA:**

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë “Partneri Shqiptar në Mikrokredi” SHA të datës 20 dhjetor 2001 që ka vendosur: 1) shitjen e 19.944 aksioneve nga totali prej 24.187 aksione, shoqërisë Opportunity Transformation Investments. Këto aksione janë shlyer nga shoqëria Opportunity Transformation Investments plotësisht kundrejt shumës 199.446.516 Lekë (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e

gjashtëmbëdhjetë lekë); 2) pranimin si aksioner, shoqerinë e shtetit Illinois Opportunity Transformation Investments e themeluar më 19 qershor 2000.

Depozitimini e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë Opportunity Transformation Investments të datës 4 dhjetor 2001 e cila ka marrë vendim për blerjen e 19.944 aksioneve që i korrespondojnë vlerës në Lekë 199.446.516 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë lekë); si dhe për emërimin e Z. Kenneth Vender Weele në të veprojë në emër të Opportunity Transformation Investments për martjen e vendimeve me rëndësi në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Depozitimini e Kontratës së Shitjes së Aksioneve të datës 20 dhjetor 2001 midis shoqërive Opportunity Transformation Investments dhe "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA.

- Urdhërohet zyra e Regjistrat Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

**GJYQTARE**  
**ANILA CAPO**  
